

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41./2014, 53/ 16 dhe 83/18), duke vepruar sipas një njoftimi për përqendrim të parashtruar nga HTL Maqedonia SHPKNJP Shkup, Rr. 50 Divizioni nr. 24 a Shkup, përmes avokatit Nikolla Lazarov nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 12.04.2023, solli

### **AKTVENDIM**

Vërtetohet se përqendrimi i cili i referohet kontrollit nga HTL Maqedonia SHPKNJP Shkup, Rr. 50 Divizioni nr. 24 a Shkup, mbi Rojal Igl SHPK Shkup, rr. Prashka nr. 23 Shkup, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për taksë administrative ( Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

### **Arsyetim**

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës më 14.03.2023, ndërsa e plotësuar më 23.03.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), është dorëzuar njoftim për përqendrim nga HTL Maqedonia SHPKNJP Shkup, Rr. 50 Divizioni nr. 24 a Shkup, ku HTL Maqedonia SHPKNJP Shkup do të fitoj kontroll ndaj Rojal Igl SHPK Shkup, rr. Prashka nr. 23 Shkup, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

#### **Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:**

HTL Maqedonia SHPKNJP Shkup kryesisht merret me lojërat e fatit, gjegjësisht marrjen dhe dhënien me qira të makinave, pajisjeve dhe mallrave materiale në fushën e lojërave të fatit dhe lojërave

argëtuese. Është pjesë e grupit Novomatik. Grupi Novomatik është një grup shoqërisht të lojërave të fatit dhe argëtimit. Grupi Novomatik prodhon dhe shet teknologji dhe pajisje për lojëra dhe argëtim dhe operon një sërë objektsh lojërash dhe argëtimi, objekte bastesh (p.sh. kazino, libra sportive, slot klube ), ofron lojëra fati dhe argëtimi në internet (online) dhe celularë, si dhe shërbime bastesh.

HTL Maqedonija SHPKNJP Shkup është 100% në pronësi të Novomatik AG Austria. Novomatik AG ka një shoqëri të lidhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut, MAKOTEN SHPKNJP Gjevgjeli, me seli në vendkalimin kufitar Bogorodicë nr. 13, Hotel Flamingo Bogorodicë Gjevgjeli, dhe me veprimtarinë e lojërave të fatit dhe basteve, gjegjësisht organizon shërbime hoteliere dhe lojëra të fatit.

HTL Maqedonija SHPKNJP Shkup ka dy kompani bijë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përkatësisht:

MA GAMING SHPKNJP Shkup me seli në Divizionin Rr. 50 nr. 24 a Shkup dhe me veprimtarinë e lojërave të fatit dhe basteve, gjegjësisht veprimtarinë e klubit për lojëra elektronike dhe

MASTERBET DOOEL Shkup me seli në bulevardin 3-të Makedonska brigada nr. 66 A, kati 3 Shkup, me veprimtarinë e lojërave të fatit dhe basteve, gjegjësisht aktivitetin e klubit për lojëra elektronike.

**RoJal Igl SHPK Shkup** kryesisht merret me lojëra të fatit dhe baste, për momentin nuk është aktive.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

### **Udhëzim për mjetin juridik**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

**KRYETAR**  
**I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS**  
**Prof. Dr. Владимир Наумовски**

